



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO	
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL	
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA	
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT	
Arkivi Qendror - Centralno Arhiva - Central Archive	
Nr./Br./No.	3084/12/3
Nr. i fq./Br. Str./No. pg.	19.09.2025
Data/Datum/Date:	PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poljoprivrede,
Šumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR) - NR. 08/2025¹
PËR KUSHTET, TARIFAT DHE PROCEDURAT PËR QIRADHËNIEN E
PRONËS PUBLIKE

¹Udhëzim Administrativ (MBPZHR) - NR. 08/2025 Për kushtet, tarifat dhe procedurat e qiradhënies e pronës publike i nënshkruar nga Zëvendësministri në detyrë i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me datë 10.09.2025

Zëvendësministri në detyrë i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,

Në mbështetje të nenit 14, paragrafi 9 të Ligjit Nr. 08/L-137 për Pyjet (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 9/ 3 Prill 2023), duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.34/18 Nëntor 2022), si dhe nenin 9 paragrafi 2, të Rregullores (QRK) – Nr.17/2024 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (publikuar në Gazetën Zyrtare - me datë 21.06.2024),

Nxjerrë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR) - NR. 08/2025¹
PËR KUSHTET, TARIFAT DHE PROCEDURAT PËR QIRADHËNIEN E PRONËS
PUBLIKE**

**KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është përcaktimi i kushteve për qiradhënie, mënyrën e shfrytëzimit, tarifat, procedurat për dhënie me qira të tokës pyjore në pronësi të Republikës së Kosovës dhe pronat tjera me të cilat menaxhon Agjencia.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Dispozitat e këtij udhëzimi administrativ janë të detyrueshme për zbatim nga Agjencia Pyjore e Kosovës, Zyra për Administrimin e Pronës Publike në Zyrën e Kryeministrit, personat fizik dhe juridik, vendor dhe të huaj që aplikojnë për qiramarrje që janë në pronësi të Republikës së Kosovës, me të cilat menaxhon Agjencia.

**Neni 3
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë këtë kuptim:

1.1. **Agjencia** – nënkupton Agjencinë përgjegjëse për pyjet e Kosovës;

1.2. **Njësia** - nënkupton Njësinë përgjegjëse për administrimin e pronës publike në kuadër Zyrës së Kryeministrit të Kosovës;

1.3. **Ministria** - nënkupton Ministrinë përgjegjëse për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural;

1.4. **Kullotë**– nënkupton tokat pyjore apo tokat bujqësore të mbuluara kryesisht me vegjetacion natyrorë bimor e cila ka shërbyer për kullotjen dhe pushimin e bagëtisë, dhe si e tillë është e evidentuar në regjistrat kadastral;

- 1.5. **Objekt i përkohshëm** – nënkupton objektin e ngritur me karakter të përkohshëm i cili pas periudhës së caktuar mund të demontohet dhe largohet nga sipërfaqja e tokës;
- 1.6. **Ndërtesat** – nënkupton ndërtimin e projektuar për banim për njerëzit apo kafshët, strehim apo ruajtje të gjësendeve, ose përdorim për aktivitete publike apo private, dhe zhvillim të tregtisë ose prodhimit;
- 1.7. **Qiradhënës** – nënkupton Agjencinë Pyjore të Kosovës e cila jep me qira pronën publike pyjore;
- 1.8. **Qiramarrësi** – nënkupton personin fizik dhe juridik i cili ka hyrë në marrëdhënie kontraktuale me pronën të cilën menaxhon Agjencia Pyjore e Kosovës;
- 1.9. **Energjia nga burimet e Ripërtërishme ose Energjia e Ripërtërishme** – nënkupton energjia prej burimeve jo-fosile , përkatësisht energjia e prodhuar nga era , solare – termo apo fotovoltaike dhe gjeo-termale, energji e ambientit, hidro – energji, biomasë, energji nga gazrat e deponive, gazi nga impiantet e trajtimit të ujerave të zeza dhe bio gazi;
- 1.10. **Pajisjet fotovoltaike** – nënkupton pajisjet që prodhojnë energji elektrike duke përdorur energjinë diellore, duke përfshirë pajisjet teknike të nevojshme për funksionimin e tyre, pajisjet e ruajtjes së energjisë dhe lidhjet në rrjet;
- 1.11. **Pajisjet e prodhimit të erës** – nënkupton pajisjet që prodhojnë energji elektrike duke përdorur energjinë e erës, duke përfshirë pajisjet teknike të nevojshme për funksionimin e tyre, pajisjet e ruajtjes së energjisë dhe lidhjet në rrjet;
- 1.12. **Person** – nënkupton personat fizik apo juridik, vendor apo të huaj;
2. Shprehjet e tjera të përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë kuptimin e njëjtë ashtu siç përcaktohet në Ligjin Nr.08/L-137 Për Pyjet.
3. Shprehjet dhe shkurtesat e përdorura në njërin gjini nënkupton edhe gjininë tjetër.

KAPITULLI II MËNYRA E QIRADHËNIES

Neni 4 Qiradhënia

1. Toka pyjore shtetërore dhe pronat tjera me të cilat menaxhon Agjencia në bazë të dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-137 për Pyje mund të jepen me qira për:
- 1.1. kultivimin e kulturave bujqësore, bimëve aromatike, bimëve medicinale dhe kultura tjera të prodhimtarisë bimërore një vjeçare;
- 1.2. kultivimin e llojeve pyjore drunore shumëvjeçare për prodhimtari drunore, biomasë;
- 1.3. kultivimin e drurëve frutore, pemëve, hardhisë;

- 1.4. kultivimin e kafshëve të egra dhe shfrytëzim të kullotave;
- 1.5. nxjerrjen e mineraleve, gurit, rërës, zhavorrit, argjilës, humusit;
- 1.6. deponimin e hirit dhe mbetjeve tjera industriale, mbeturinat urbane, mbeturinat e industrisë së drurit;
- 1.7. ndërtimin e objekteve të përkohshme në zona pyjore për rekreacion familjar, shtëpizë malore, shtëpizë për blegtor, shtëpi të bjeshkatarëve;
- 1.8. ndërtimin e objekteve të përkohshme për aktivitete biznesore buzë rrugëve magjistrale dhe regjionale;
- 1.9. ndërtimin e objekteve të përkohshme për aktivitete biznesore buzë rrugëve magjistrale dhe regjionale;
- 1.10. vendosjen e pajisjeve për prodhimin e Energjisë së Ripërtërishme;
- 1.11. vendosjen e instalimeve të ndryshme;
- 1.12. vendosjen e antenave transmetuese apo antenave tjera;
- 1.13. hapje të trasesë - rrugëve të përkohshme për nevojat e realizimit të aktiviteteve si në nën-paragrafët 1.5, 1.6, 1.7, 1.8, 1.9, 1.10, 1.11, dhe 1.12, të paragrafit 1 të këtij neni;
- 1.14. Objektet ekzistuese me të cilat menaxhon Agjencia në zonat urbane dhe rurale;
- 1.15. Hapja e traseve të largpërçuesve, kanale për futje të tubacioneve të ujërave, kablllove

KAPITULLI III TARIFAT

Neni 5 Pagesa për Qira

1. Për tokën pyjore dhe pronat tjera me të cilat menaxhon Agjencia sipas dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-137 për Pyje të dhënë me qira, qiramarrësi është i detyruar të paguajë qiranë.
2. Qiraja paguhet në llogarinë valide bankare të Agjencisë – Buxhetin e Republikës së Kosovës.
3. Qiraja mund të paguhet edhe me këste.
4. Nëse qiraja paguhet me këste, çdo këst individual llogaritet duke e ndarë shumën e përgjithshme të qirasë në shuma të barabarta sipas numrit të viteve apo muajve për të cilat është marrë qiraja, me kusht që të paguhet kësti i parë ditën e lidhjes së kontratës për qiradhënien.
5. Kushtet dhe afatet për pagesën e qirasë përcaktohen me kontratën për qiradhënien.

Neni 6

Tarifat për qiradhënien

1. Qiradhënia e tokës për kultivimin kulturave bujqësorë, bimëve aromatike, bimëve medicinale dhe kultura tjera të prodhimtarisë bimore një vjeçare – 50.00 euro/Ha/Vit.
2. Qiradhënia e tokës për kultivimin e llojeve pyjore drunore shumëvjeçare për prodhimtari drunore, biomasë etj. 50.00 euro/Ha/Vit.
3. Qiradhënia e tokës për kultivimi e drurëve frutorë, pemëve, hardhisë 50.00 euro/Ha/Vit.
4. Qiradhënia e tokës kultivimin e kafshëve të egra dhe për shfrytëzim të kullosave 50.00 euro/Ha/Vit.
5. Qiradhënia e tokës për nxjerrjen e mineraleve gurit, rërës, zhavorrit, argjilës, humusit 0.10 euro/m²/vit dhe obligimi për pyllëzimin e sipërfaqes së njëjtë të marrë me qira dhe mirëmbajtje për 3 vjetarin e parë të mbjelljes së fidanëve. Kushtet, mënyra e pyllëzimit dhe lokacioni përcaktohet nga Agjencia.
6. Qiradhënia e tokës për hapje të trasesë - rrugëve të përkohshme për qasje në prona ose objekte, trase të largpërçuesve, kanale për futje të tubacioneve të ujërave, kablllove etj. 0.20 euro/m²/vit;
7. Qiradhënia e tokës për deponimin e hirit dhe mbetjeve tjera industriale, mbeturinave urbane, mbeturinat e industrisë së drurit 0.10 euro/m²/vit.
8. Qiradhënia e tokës për ndërtimin e objekteve të përkohshme në zona pyjore për rekreacion familjar, shtëpizë malore, shtëpizë të bjeshkatarëve 0.20 euro/m²/vit.
9. Qiradhënia e tokës për ndërtimin e objekteve të përkohshme në zona pyjore për shtëpize për blegtori (stane) dhe objekte për kafshë 0.05 euro/m²/vit.
10. Qiradhënia e tokës për ndërtimin e objekteve të përkohshme për aktivitete biznesore buzë rrugëve magjistrale dhe regjionale 0,40 euro/m²/vit;
11. Qiradhënia e tokës për ndërtimin e objekteve të përkohshme për aktivitete biznesore dhe aktiviteteve tjera jashtë rrugëve magjistrale dhe regjionale 0.30 euro/m²/vit;
12. Qiradhënia e tokës për vendosjen e pajisjeve (turbinave) për prodhimin e energjisë alternative, nga era 1,000.00 euro/vit/ - bazamenti ku vendosen turbina, shtrirja e kablllove dhe instalimeve tjera të ndryshme apo hapja e rrugëve të reja llogaritet sipas paragrafit 1.6 të këtij neni);
13. Qiradhënia e tokës për vendosjen e pajisjeve fotovoltaike për prodhimin e energjisë solare 0.05 euro/m²/vit;
14. Qiradhënia e tokës për vendosjen e antenave transmetuese apo antenave tjera 100.00 Euro/muaj/bazamenti, - nëse kërkohet sipërfaqe shtesë me shumë se vendosja standarde e bazamentit atëherë sipërfaqja shtesë llogaritet sipas paragrafit 6 të këtij neni;

15. Qiraja për objektet ekzistuese urbane për m² në muaj bëhet sipas vlerësimit të çmimit të tregut përmes komisioneve vlerësuese, duke llogaritur sipërfaqen sipas planimetrise së objektit apo pjesës se njësisë.

16. Qiraja për objektet ekzistuese rurale për m² në muaj bëhet sipas vlerësimit të çmimit të tregut përmes komisioneve vlerësuese, duke llogaritur sipërfaqen sipas planimetrise se objektit apo pjesës se njësisë.

KAPITULLI IV PROCEDURAT

Neni 7

Qiradhënia përmes marrëveshjes së drejtpërdrejtë

1. Kërkesat e subjekteve biznesore, personave juridik dhe fizik të parashtruara në Agjencinë Pyjore të Kosovës për vazhdimin dhe zgjerimin të aktiviteteve të tyre biznesore vlerësohen, trajtohen me prioritet – përparësi nga Agjencia përkatësisht Njësia për administrimin e pronës publike në kuadër Zyrës së Kryeministrit të Kosovës.

2. Kërkesat nga paragrafi 1 i këtij neni shqyrtohen me marrëveshje të drejtpërdrejtë të palëve kontraktuese.

3. Procedura fillon me ushtrimin e kërkesës për shprehje të interesit nga personat fizik dhe juridik vendas dhe të huaj në njërën nga mënyrat e aplikimit përmes:

3.1. kopjes fizike;

3.2. përmes postës elektronike zyrtare të Agjencisë Pyjore të Kosovës, dhe

3.3. shërbimit postar;

4. Kërkesat e ushtruara në Agjencinë Pyjore të Kosovës regjistrohen në arkivin e saj;

5. Kërkesa duhet të përmbajë këtë dokumente:

5.1. Certifikatën e pronës – të lëshuar nga autoriteti përkatës me autorizim nga Agjencia Pyjore e Kosovës jo më të vjetra se gjashtë (6) muaj nga dita e dorëzim - pranimit;

5.2. Kopjen e planit jo më të vjetra se gjashtë (6) muaj nga dita e dorëzim - pranimit;

5.3. Skicën me koordinata për sipërfaqen e kërkuar të parcelës, nëse ka objekt të përfshihet planimetria e objektit nga organi kompetent komunal apo Gjeodezi i licencuar;

5.4. Kopjen e Letërnjoftimit apo pasaportës për personin fizik;

5.5. Certifikatën e biznesit për personat juridik;

5.6. Planin e Ri kultivimit për sipërfaqet e kërkuara kur ka ndërrim destinim;

5.7. Kopjen e letërnjoftimit për personat fizik dhe përfaqësuesit e personave juridik.

Neni 8

Vlerësimi i kërkesave

1. Kërkesat shqyrtohen nga ana e komisionit vlerësues për shqyrtimin e kërkesave për dhënien e tokave pyjore dhe pronat tjera me të cilat menaxhon Agjencia në bazë të dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-137 për Pyje.
2. Kërkesat e ushtruara dhe të kompletuar pas regjistrimit në Arkivin e Agjencisë të njëjtat pranohen nga ana e Komisionit shqyrtues për vlerësimin e kërkesave për dhënien e tokave pyjore dhe Tokat tjera shtetërore, sipas dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-137 për Pyje.
3. Komisioni vlerësues bënë shqyrtimin e kërkesave, harton raport të konstatimit të gjendjes dhe lëndën e përgatit për dërgim tek Njësia për Administrimin e Pronës Publike për pajisje me Pëlqim.
4. Lëndën e vlerësuar dhe të kompletuar nga paragrafi 1 i këtij neni zyrtarisht procedohet në Njësinë për administrimin e pronës publike në kuadër Zyrës së Kryeministrit të Kosovës, përmes Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës.

Neni 9

Qiradhënia përmes grumbullimit të ofertave

1. Agjencia bënë planifikimin vjetor të parcelave të tokave pyjore dhe pasurive të tjera në pronësi publike, me të cilat menaxhon në bazë të dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-137 për Pyjet, të cilat synon t'i japë me qira në bazë të ofertave të grumbulluara.
2. Planifikimi vjetor i parcelave për qiramarrje nga paragrafi 1 i këtij neni, hartohet dhe miratohet përmes planit vjetor për pyje në përputhje me objektivat e menaxhimit pyjor dhe prioritet institucionale.
3. Pas miratimit të planit vjetor Agjencia publikon njoftimin publik për grumbullimin e ofertave ne ueb faqen zyrtare të saj dhe në një mjet tjetër të informimit publik.
4. Njoftimi publik përmban:
 - 4.1. përshkrimin e parcelës apo pasurisë publike të planifikuar për qiramarrje;
 - 4.2. afatin e qirasë;
 - 4.3. qëllimin e lejuar të shfrytëzimit;
 - 4.4. kriteret për përzgjedhjen e ofertuesit;
 - 4.5. dokumentacionin e kërkuar;
 - 4.6. afatin për dorëzimin e ofertave;

4.7. mënyrën dhe adresën e dorëzimit të ofertave.

5. Pas përfundimit të afatit të pranimit të ofertave, komision i emëruar nga Agjencia bënë hapjen dhe vlerësimin e ofertave në bazë të kriterëve të përcaktuara në njoftim dhe harton raportin përfundimtar për përzgjedhjen e ofertuesit më të favorshëm.

6. Kontratat e qirasë lidhet me ofertuesin fitues pas përfundimit të procedurës në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe sipas kushteve dhe kriterëve të këtij Udhëzimi Administrativ.

7. Procedura për dhënien me qira në bazë të ofertave të grumbulluara konsiderohet i përfunduar edhe në rastet kur nuk paraqitet asnjë ofertë ose të gjitha ofertat refuzohen si të pranueshme.

Neni 10

Qiradhënia përmes ankandit publik

1. Agjencia, për pronat në pronësi publike nën menaxhimin e saj, mund të organizoj procedurën e ankandit publik.

2. Planifikimi i parcelave për dhënie me qira përmes ankandit bëhet duke u bazuar në objektivat e menaxhimit pyjor, prioritetet institucionale dhe përdorimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore.

3. Agjencia, shpall publikisht ankandin në faqen zyrtare të institucionit dhe në së paku një mjet tjetër publik të informimit.

4. Njoftimi publik për ankandin përmban këto të dhëna:

4.1. përshkrimin e parcelës apo pasurisë publike që jepet me qira;

4.2. afatin e qirasë;

4.3. qëllimin e lejuar të shfrytëzimit;

4.4. çmimin fillestar të ankandit;

4.5. kushtet për pjesëmarrje në ankand;

4.6. dokumentacionin e nevojshëm për aplikim;

4.7. kohën, vendin dhe mënyrën e mbajtjes së ankandit;

4.8. mënyrën e dorëzimit dhe afatin për aplikim.

5. Ankandi organizohet nga agjencia, e cila siguron mbarëvajtjen e procedurës, hapjen dhe vlerësimin e ofertave publike dhe përzgjedh ofertuesin.

6. Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë emëron komision të posaçëm për vlerësimin e ofertave publike dhe përzgjedhjen e ofertuesit.

7. Kontrata e qirasë lidhët me ofertuesin fitues pas përfundimit të procedurës së ankandit, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe kushtet e përcaktuara në këtë udhëzim administrativ.

8. Procedura e ankandit publik konsiderohet e mbyllur edhe në rastet kur:

8.1. nuk paraqitet asnjë ofertues;

8.2. asnjë nga ofertuesit nuk përmbush kriteret ligjore dhe administrative.

Neni 11

Emërimi i komisionit vlerësues

1. Komisioni vlerësues për shqyrtimin e kërkesave për dhënie të tokave pyjore dhe pronat tjera me të cilat menaxhon Agjencia, emërohet me vendim nga Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë.

2. Komisioni i vlerësimit për shqyrtimin e kërkesave përbëhet nga tre (3) anëtarë.

Neni 12

Komisioni për shqyrtimin e ankesave

1. Komisioni për shqyrtimin e ankesave caktohet me vendim nga Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë.

2. Komisioni nga paragrafi 1 i këtij neni përbëhet nga tre (3) anëtarë.

3. Komisioni nga paragrafi 1 i këtij neni i shqyrton ankesat në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Neni 13

Kontrata për dhënie me qira të tokës pyjore publike - shtetërore dhe pronat tjera me të cilat menaxhon Agjencia

1. Pas shqyrtimit të kërkesave të Komisionit vlerësues nga neni 10 i këtij Udhëzimi Administrativ, dhe Pëlqimit të marrë nga Njësia për Administrimin e Pronës Publike në Zyrën e Kryeministrit si dhe Vendimit nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Agjencia lidh kontratë të drejtpërdrejtë për qiradhënie të tokës pyjore dhe pronat tjera me të cilat menaxhon Agjencia në pajtim me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në Rregulloren (QRK)-NR.03/2025 për Kushtet e Bartjes së Pronësisë së Pronës Publike dhe Dhënie me Qira të Sendeve në Pronësi Publike.

2. Tokat pyjore në pronën shtetërore nuk mund të jepen me nën qira pa pëlqimin paraprak të qiradhënësit.

Neni 14

Kohëzgjatja e Qiradhënies

1. Të drejtat dhe obligimet e qiradhënësit dhe qiramarrësit përcaktohen me Kontratë në pajtim me Ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve.

2. Tokat pyjore të dhëna me qira nga paragrafi 1 i këtij neni mund të jepen me qira deri në pesëmbëdhjetë (15) vite me mundësi vazhdimi.

3. Vazhdimi i shfrytëzimit të tokës pyjore nga paragrafi 2 i këtij neni, mund të bëhet me marrëveshje reciproke nga palët kontraktuese, bazuar në kontratën paraprake, nëse shfrytëzuesi i tokës pyjore e ka zbatuar në tërësi kontratën përkatëse dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 15

Mbikëqyrja e Kontratave të qiradhënies

1. Agjencia është përgjegjës për mbikëqyrjen e përmbushjes së detyrimeve kontraktuale dhe mbikëqyrjen e kontratave të lidhura në përputhje me Legjislacionin në fuqi dhe këtë udhëzim administrativ.

2. Agjencia mban dhe përditëson regjistrin zyrtar të kontratave për dhënien me qira të tokave pyjore.

3. Të gjitha kontratat për dhënie me qira të tokave pyjore që janë në fuqi publikohen në web-faqen zyrtare të Agjencisë.

4. Përfundimisht nga paragrafi 3 i këtij neni, Agjencia duke u bazuar në Ligjin për Qasje në Dokumente Publike mund të mos publikoj kontrata të caktuara.

Neni 16

Mosshfrytëzimi i sipërfaqes sipas qëllimit

1. Nëse qiramarrësi, brenda një (1) viti nga data e lidhjes së kontratës, nuk e shfrytëzon sipërfaqen e dhënë me qira në përputhje me destinimin e përcaktuar në kontratë, Agjencia Pyjore e Kosovës ka të drejtë të ndërpresë kontratën në mënyrë të njëanshme, pa kompensim.

2. Qiramarrësi mund të kërkojë shtyrje të afatit deri në gjashtë (6) muaj, nëse dëshmon me dokumentacion të besueshëm se vonesa ka ardhur si rezultat i rrethanave të jashtëzakonshme, arsyeve të justifikuara apo *forcës madhore*.

3. Kërkesa për shtyrje duhet të paraqitet me shkrim brenda afatit fillestar njëvjeçar.

4. Në rast të mosshfrytëzimit të sipërfaqes as brenda afatit të shtyrë, kontrata ndërpritet në mënyrë të njëanshme nga Qiradhënësi, me shkrim dhe pa obligime kompensuese ndaj qiramarrësit.

Neni 17

Refuzimi i kërkesave të kundërta me interesat dhe Programet e Agjencisë

1. Agjencia ka të drejtë të refuzojë çdo kërkesë, leje, autorizim që është në kundërshtim me interesat e saj institucionale, objektivat strategjike dhe programet e miratuara.

2. Refuzimi i kërkesës bazohet në vlerësimin profesional të Agjencisë, duke marrë parasysh:

- 2.1. Mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe burimeve natyrore;
 - 2.2. Planifikimin strategjik dhe politikat e miratuara për menaxhimin pyjor;
 - 2.3. Ndikimin negativ në biodiversitet, ekosisteme dhe mjedisit;
 - 2.4. Çdo rrethanë tjetër që cenon funksionimin dhe qëllimet e Agjencisë.
3. Vendimi për refuzimin e kërkesës do të arsyetohet me shkrim dhe do t'i komunikohet palës së interesuar brenda afateve ligjore të përcaktuara sipas LPPA.
4. Pala e pakënaqur ka të drejtë të ushtrojë ankesë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KAPITULLI V

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE

Neni 18

Procedimi i kërkesave

1. Obligohet Agjencia Pyjore e Kosovës që përmes komisioneve të veçanta të shqyrtoj dhe të procedoj tek Njësia për Administrimin e Pronës Publike në Zyrën e Kryeministrit të gjitha kërkesat e ushtruara për dhënien e tokës pyjore me qira, që janë në pajtim me nenin 76 paragrafi 8 të Ligjit Nr. 08/L-137 për Pyjet, me kusht që të jenë në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara sipas këtij Udhëzimi Administrativ dhe legjislacionit në fuqi.
2. Agjencia Pyjore e Kosovës, obligohet që të shqyrtoj dhe të procedoj tek Njësia për Administrimin e Pronës Publike në Zyrën e Kryeministrit për pajisje me pëlqim dhe vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, kërkesat e ushtruara nga aplikuesit/personat, duke zbatuar afatet dhe tarifat e përcaktuara në nenin 8 paragrafi 4 dhe nenin 14 paragrafi 3 të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 19

Shqyrtimi i kërkesave

Kërkesat e parashtruara për vazhdimin dhe zgjerimin të aktiviteteve të tyre biznesore deri në hyrje në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ për qiradhënie/marrje në Agjencinë Pyjore të Kosovës, sipas këtij Udhëzimi Administrativ shqyrtohen me marrëveshje të drejtpërdrejtë, me përparësi dhe procedurë të shkurtuar në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 20

Të hyrat

Të gjitha të hyrat që rrjedhin nga zbatimi i këtij Udhëzimi Administrativ derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Neni 21

Dispozitat Shfuqizuese

1. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi administrativ shfuqizohen:

1.1. Udhëzimi Administrativ NR.10/2010 të datës 19.08.2010 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.41/2006 për Ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore të datës 27.12.2006;

1.2. Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2011 të datës 01.02.2011 Për Ndryshim Plotësimin e Udhëzimit Administrativ NR.10/2010 për Ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, të datës 19.08.2010;

1.3. Udhëzimi Administrativ 01/2020 të datës 11.06.2020 Për Ndryshim Plotësimin e Udhëzimit Administrativ NR.10/2010, Për Ndryshim Plotësimin e Udhëzimit Administrativ NR. 41/2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, të datës 27.12.2006.

Neni 22
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas Publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Lazar RADULOVIĆ

Zëvendësministër në detyrë i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

15/09/2025